# UDHËTIM NË VIA EGNATIA




AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT

Agjencia Kombëtare e Bregdetit është ngritur për herë të parë si institucion në Janar të 2014. Funksioni i saj është monitorimi dhe menaxhimi i vijës bregdetare.

Duke qenë se në territorin ku Agjencia ka juridiksionin e saj, ndodhen dy stacionet kryesore prej nga fillon Via Egnatia, Durrësi dhe Apollonia, atëherë Agjencia Kombëtare e Bregdetit është dhe nismëtarja për projekt propozimin për rivitalizimin e Rrugës Egnatia.

Ky projekt do të jetë në fokus të disa institucioneve si Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Kulturës, Ministria e Transportit dhe grupet e interesit lokal.










## GJENDJA AKTUALE E RRUGËS
Pjesë të mbetura të rrugës Egnatia


Lumi Shkumbin




Hani i Hoxhes


Mirake


Bradashesh

# SFONDI HISTORIK




Ështe ndërtuar diku në mesin e viteve 149-120 p.e.s nga Prokonsulli romak i Maqedonisë Gnaeus Egnatius mbi gjurmën e një rruge e cila sipas Aristotelit lidhte bregdetin e Adriatikut me viset e Maqedonisë dhe Trakisë

## Periudha romake

Roma ndërtoi rrugët për të kontrolluar territoret e pushtuara. Nga Via Egnatia në thellësi të gadishullit të Ballkanit legjionet romake udhëtonin me lehtësi duke kapur distanca rekord për kohën. Një ushtar romak mund të udhëtonte 35 deri në 40 km në ditë. Via Egnatia ishte arteria kryesore e lëvizjes së ushtrisë romake gjatë Luftës Civile midis Pompeut dhe Cezarit. Disa nga betejat më të rëndësishme të këtyre dy figurave legjendare të Romës antike u zhvilluan përgjatë rrugës Egnatia.

Përgjatë Via Egnatia-s udhëuan gati të gjithë emrat e njohur të botës romake si Ciceroni, Mark Antoni, Brutus, Ahenobarbous, Pompeu Plak, Pompeu i Ri, Perandori Trajan e keshtu me rradhe...

*"Një ushtar bën mirë të mos lërë rrugën, por të ndjeki komandantin e tij, sepse oficer nuk e konsideron çfarë i shkon përshtat vetes së tij, por ajo që është e mundur për të gjithë. Kjo është arsyeja pse ai vendos ndalesa. Ushtria marshon tre ditë dhe ndalet të katërtën. Qytetet zgjidhen të kenë një distancë prej tri apo katër ditë nga njëri-tjetri, apo edhe më shumë, në qoftë se ka është shumë ujë dhe furnizimet janë të bollshme; kështu që udhëtimi bëhet pa lodhje, deri sa të arrijnë në vendin e zgjedhur, si të ishte qyteti mbretëror, ku ushtritë e lodhura gjejnë pije freskuese "( Psalmi 118 (119), vargu 33)*


Jul Çezari


Pompei


Ciceroni


Mark Antoni


Brutus



## Periudha Kristiane

Në shekujt e parë të e.s në Via Egnatia filluan të duken disa predikues të çuditshëm, të cilët sillnin fjalët dhe mesazhet e një të panjohuri me emrin Jezus.

Rruga Egnatia u quajt "këmbët e bukura" të krishterëve. Kristjanët e parë që kanë ecur në këtë rruge ishin apostujt Pjetri, Silvani, Gjon Mark dhe Timoteu në vitin 42 p.e.s. Më vonë, Apostulli Pal dhe pasuesit e tij kanë udhëtuar në këtë rrugë të paktën tre herë. Besimtarët nga qytetet Filipi dhe Selaniku e përdorën atë për të përhapur Ungjillin.




## Barbarët

Via Egnatia ishte arsyeja kryesore e vërshimeve barbare në Ballkan. Me rënien e fuqisë së Romës, një mori fisesh që kapërcyen kufirin e perandorisë sulmuan Ballkanin pikërisht nëpërmjet Via Egnatia-s.
Me rënien e Romës dhe fuqizimin e Perandorisë së Lindjes të njohur me emrin Perandoria Bizantine, Via Egnatia vazhdoi të ishte arteria kryesore e trafikut midis Europës së pushtuar nga barbarët dhe Lindjes Bizantine. Ishte Via Egnatia dhe degezimet e saj të cilat në këtë periudhë vakumi të pushtetit në Ballkanin Perëndimor bënë të mundur penetrimin Sllav drejt Greqisë dhe fuqizimin e ndikimit sllavo-bullgar. Megjithatë pas periudhës së errët të fillimit të Mesjetës Via Egnatia kaloi plotësisht nën pushetin Bizantin, i cili ndërmori një sërë restaurimesh dhe fortifikimesh.

## KRYQEZATAT

"Që nga koha e pelegrinëve gjerman në 1064 të cilët vizitonin Jeruzalemin, Via Egnatia nuk kishte parë kaq shumë të krishterë"

Në  Nëntor të 1095, Papa Urban i II përpara një mase të madhe njerëzish bëri ndoshta fjalimin me më ndikim në Periudhen Mesjetare duke nisur një Kryqëzatë dhe duke ftuar të krishterë nga e gjithe Europa për një luftë frontale me myslimanët dhe për të rimarrë Tokën e Shenjtë nën thirrjen: "Deus vult!" (Me vullnetin e Zotit)

Via Egnatia ishte rruga kryesore ku kryqëtarët europian udhëtuan për të mbërritur në Konstandinopojën perandorake. Nga Porti i Durrësit ku mbërrinin anijet kryqëtare, udhëtuan në Via Egnatia disa nga emrat më të njohur të Evropës kristiane si: Bohemundi  Princi i Antiokut, Geofrey de Bullion, Raymond de Hateuville Count of Tulon, Roberti i II Konti i Flandrës,




Kjo periudhë historike është mjaft e dokumentuar nga kronikanët  dhe udhëtimi i kryqëtarëve nëpërmjet territoreve shqiptare në Via Egnatiaështëmjaft interesant.

Po kështu, në Durrës,  me peripeci të mëdha mbërriti edhe Hugo i Orleanit, vëllai i Mbretit të Francës, që ju bashkua edhe ai ushtrisë Kryqëtare nëpërmjet Via Egnatia.
"...Në këtë kohë Guvernator i Durrësit ishte Gjoni, djali i Isakut, Sevastokrati nip I Perandorit Kommnenus. Nikolaus Maurokatakalon, që ishte edhe komandant i flotës, kishte vendosur anijet në stacione rreth portit të Durrësit, në mënyrë që ai të mund të lundronte dhe të kontrollonte ujërat në rast se ndonjë anije pirate afrohej. Pasi mori letrën nga Hugo i Orleanit, Perandori dërgoi fjalë tek Guvernatori i Durrësit të kenë kujdes kontrollin nga toka dhe deti për ardhjen e Hugos. Me ardhjen e tij një korrier do të dërgohej menjëherë tek Perandori. Sidoqoftë Hugo duhej pritur shumë mirë. Ai më tej urdhëroi komandantin e flotës të ishte në rojë në mënyrë të vazhdueshme. Ndërkohë Hugo, mbërriti në bregun e Longobardi, prej andej ai dërgoi 24 lajmëtarë tek Guvernatori I Durrësit, secili I zbukuruar me ar dhe parzmore të kuqe. Bashkë me ta ishte edhe Konti Karpenter dhe Helia që ishte larguar nga Perandori, në Selanik. Ata i çuan këtë mesazh Guvernatorit të Durrësit:
"Ju njoftojmë, Guvernator, se zotëria ynë Hugo së shpejti do të jetë këtu dhe do të sjellë me vete flamurin e artë të Shën Pjetrit nga Roma. Për më tëpër, duhet të dini se ai është drejtuesi më i lartë i të gjitha ushtrive të Francës.  Përgatituni për ta pritur atë dhe ushtrinë e tij si dhe ti bindeni ashtu siç e meriton."
Ndërsa ata urdhëronin Guvernatorin, siç thuhej Hugo erdhi nga Roma në Longobardi, u nis për në Iliri nga Bari; gjatë udhëtimit e zuri një stuhi e tmerrshme dhe humbi pjesën më të madhe të anijeve të tij bashkë me vozitësit dhe pasagjerët. Varka e vogël me të cilën ai shpëtoi, u shty nga valëte detit në breg diku midis Durrësit dhe një vendi të quajtur Palus." (Nga  Anna Commnena)


Robert II,
Count of Flanders


Guglielmo Embriaco


Stephen,
Count of Blois


Adhemar of Le Puy


Robert Curthose


Baldwin I
of Jerusalem


Bohemond I
of Antioch


Godfrey of Bouillon


Hugh I,
Count i Vermandois


Raymond IV,
Count i Toulouse


Tancred,
Prince of Galilee

A very important event for the time was the Treaty of Devol between the Norman army, led by the legendary Prince Bohemond, and the Emperor Alexois Komnenos. The Norman army, while traveling along the Via Egnatia, came across the Byzantine army under the command of the Emperor on the field of Devol. This is where the agreement was doctored, on the field of the same name.



> "I swear to thee, our most powerful and holy Emperor, the Lord Alexios Komnenos, and to thy fellow-Emperor, the much-desired Lord John Porphyrogenitos that I will observe all the conditions to which I have agreed and spoken by my mouth and will keep them inviolate for all time and the things that are for the good of your Empire I care for now and will for ever care for and I will never harbor even the slightest thought of hatred or treachery towards you [...] and everything that is for the benefit and honor of the Roman rule that I will both think of and execute. Thus may I enjoy the help of God, and of the Cross and of the holy Gospels."



The Via Egnatia was a very important road for the Second Crusade, the Third Crusade, and the Fourth Crusade because the armies marched upon it.

**Perudha Otomane**

Me mbarimin e Kryqëzatave dhe ngritjen e dinastisë së Otomanëve, Via Egnatia pa nje vërshim të ri të ushtrive dhe tregtarëve por këtë rradhë nga Lindja. Armatat Otomane nëpërmjet Via Egnatia-s mbërritën në Ballkan dhe filluan sundimin e tyre të gjatë. Gjatë kësaj periudhe Via Egnatia u riparua si dhe ju shtuan mjaft vepra arti sidomos në zonën e Lumit Shkumbin. Nga Otomanët u rindërtua edhe një prej stacioneve të mëdha të ndërrimit të kuajve, Skampis i cili nën komandën e Mehmet Pushtuesit u quajt Ilbasan apo Elbasani i sotëm.

Kalaja e lashtë e Elbasanit, një nga më madhështoret në botë. Sipas kronistit Latin, ky qytet i lashtë ishte i pari që u themelua nga Philip, sundmtari i kalasë së Kavalas, ne kohën e Aleksandrit të Madh. Flozofë të shumtë qëndruan në këtë qytet duke e bërë të lulëzojë. Përfundimisht, pasi u drejtua nga qindra mbretër dhe mbretëresha, tokat e Rumelisë ranë në kushte arkaike dhe ky qytet i madh u sundua nga dy djemtë e despotit Serb, të quajtur Banya dhe Basanya, dhe u sundua prej të dyve bashkë. Këta vëllezër të potershëm ishin të paaftë të shmangnin grindjet dhe luftimet ndërmjet tyre. Në fund, Basanya u lodh nga lufta dhe u strehua me Sulltan Mehmed. Në prani të sulltanit ai ngriti gishtin tregues dhe shqiptoi besimin monoteist, kështu konvertimi në Islam sipas instruksioneve të Ak Shemseddin" 1670, Evliya Chelebi: Seyahatname



Udhëtarët romantik të shek. 19

Via Egnatia ishte për udhëtarët romantikë të she 19 një prej rrugëve më të rëndësishme drejt lindjes orientale. Të frymëzuar nga rilindja romantike e udhëtimeve drejt orientit, një sërë emrash të rëndësishëm të asaj periudhe e shkelën atë. Një prej tyre piktori Edward Lear ka lënë disa piktura pejzazhesh të mrekullueshme nga udhëtimi i tij nëpër Via Egnatia, sidomos në luginën e Shkumbinit. Ndoshta udhëtari më i rëndësishëm që preku Via Egnatia-n për herë të fundit ishte Princi i Wellsit dhe Mbreti i ardhshëm i Anglisë Eduardi i VII i cili në shkurtin e 1862 zbriti në Portin e Durrësit në stacionin e parë të Via Egnatia.





**Via Egnatia gjatë Luftës së Parë Botërore**


Elbassan
26 September
1848


Elbassan.
26. Sept. 1848.


Elbassan 26. Septr. 1848.


Elbassan
26 Sept. 1848

# VIA EGNATIA

## PROJETK PROPOZIM

AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT







Një studim i gjurmës së rrugës Egnatia midis qyteteve Filip dhe Aleksandropoli është
bërë nga dy inxhinierë nga Universiteti i Trakës në Xanthi, Greqi, me ndihmën e arkeologëve
nga Ephoreia dhe Komotini.

Nga studimi është konstatuar se projektimi dhe ndërtimi i rrugës Egnatia është bazuar në njohuri specifike. Në një gërmim arkeologjik në trotuarin e rrugës në zonën e Trakës janë gjetur deri në katër shtresa guri. Trashësia e trotuarit varionte nga 25 cm deri ne 150 cm. Materialet e përdorura ishin kryesisht me origjinë vendase. Gjerësia e rrugës shkonte nga 4 m në 8 m, në varësi të kushteve të terrenit dhe kërkesave të trafikut. Në qytete gjerësia e rrugës arrinte deri në 20 m për të përballuar rritjen e trafikut.

SHTYLLAT ROMAKE NË RRUGËN EGNATIA

Përgjatë rrugës, në intervale prej 1 milje janë vendosur shtylla guri të quajtura Miliarë

Shtylla e parë u gjet rreth shtatë kilometra Romake në perëndim të Selanikut.
Kjo shtyllë kishte një mbishkrim dygjuhësorë; në gjuhën latine dhe greke.

Shtylla e dytë Romake me mbishkrimin Egnatius është gjetur në afërsi të Kavala-s (Neapolisi i lashtë) dhe kishte numrin 6, që tregonte se ajo ishte gjashtë milje nga Philippi





Miliar i zbuluar ne Apolloni.




Projekti Via Egnatia mund të zhvillohet në disa faza me afate konkrete.

1. Identifikimi historik i rrugës
2. Identifikimi i aseteve kulturore përgjatë Via Egnatias.
3. Ngritja e stacionit kryesor të informacionit të VIA Egnatia në Durrës pranë Amfiteatrit. Ky stacion do të jetë vendi kryesor i fillimit të itinerarit historik.
4. Ngritja e stacionit kryesor të informimit të VIA Egnatias në Qafe Thanë për turistë që futen në shqiperi
5. Kordinatat në GIS të rrugës nga Durrësi dhe Apolonia deri në Ohër.
6. Tabelizimi, informacioni rrugor dhe shesh pushimet përkatëse
7. Tabelizimi rural i të gjithë itinerarit historik (tabela me bar kode të lidhura me websitin e Western Balkans të mbeshtetur nga National Geographic)
8. Vendosja e Miliareve, gurë kilometrik, sipas modelit romak.
9. Trajnimi dhe edukimi i guidave lokale përgjate Via Egnatia
10. Ringritja i stacioneve romake (Mutatio) në stilin e staneve tradicionale. Këto stacione do të operohen nga operatorë lokal.
11. Organizimi i karvaneve tradicionale periodike
12. Paralelisht një fushatë e fortë publicitare për të promovuar VIA Egnatia-n brenda dhe jashtë vendit.
13. Restaurimi i pjesëve të Via Egnatia-s nëpërmjet kampeve verore
14. Botimi i një sërë publikimesh mbi historinë e Via Egnatias.
15. Drejtimi i fluksit turistik drejt Via Egnatia si një produkt i rendësishëm kulturor-historik europian


Rrugë këmbësorësh
Apollonia
Rrugë bicikletash
Apollonia
Rrugë automobilistike
Apollonia




Fillimi i rruges do te jete Kalaja e Durresit











Tabelat informuese te ndara ne :
tabela rrugore - shpjegohet

## PROPOZIMI I GURËVE KILOMETRIK DHE STACIONEVE TË PUSHIMIT









Gur miliar - Apolloni

## EVIDENTIMI I MONUMENTEVE PËRGJATË RRUGËS EGNATIA



Durrës (Dyrrah) – Peqin (Klodiana)
Një fillim i këndshëm dhe i lehtë. Ky itinerar kalon mbi kodrat e gjelbërta në Durrës dhe Kavajë. Shënjat e para të dukshme të Rrugës Egnatia, pra rruga e shtruar me kalldrëm dhe një urë e vogël romake janë në afërsi të Peqinit. Rruga kalon nëpër lëndina, liqene dhe ullishte dhe ofron pamje të detit dhe sigurisht të rrugës së vjetër Egnatia pa zhurmën e trafikut. Pejzazhe rurale, kontakti me fshatarët, tingujt e qyqeve dhe bilbilave janë shoqëruesit tuaj.

Faza e parë Seksioni Golem – Tilaj – Seferaj – Golemas – Zikularaj – Helmas – Memzote

| | |
|---|---|
| Distance | 18.5km |
| Maximum altitude | 140m |
| Total ascent/descent | 460m/430m |
| Rating | easy, intermediate after rainfall |
| Maps | Soviet maps K-34-100-A+C |
| Water | ask at farmhouses |
| Accomodation | ask in Memzote. Hotel at main road Krieuz |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Wp1 | 41°14.831'N | 19°31.922'E | Wp2 | 41°14.802'N | 19°33.847'E |
| Wp3 | 41°14.502'N | 19°34.104'E | Wp4 | 41°13.797'N | 19°35.312'E |
| Wp5 | 41°13.130'N | 19°35.675'E | Wp6 | 41°10.650'N | 19°35.784'E |
| Wp7 | 41°10.252'N | 19°36.434'E | Wp8 | 41°09.625'N | 19°36.280'E |




Ecja nis tek stacioni i autobuzit në qëndër të Golemit. Disa autobuzë nuk hyjnë në Golem por ndalojnë tek rruga në hyrje ë Golemit. Prej këtej ecet 500 m në Lindje për të arritur në pikën e fillimit. Ec në rrugën kryesore në drejtimin Veri deri tek Hotel Ulpiana (Ëp1) dhe aty kthehesh në të djathtë. Ndiq rrugën me çakull për rreth 2.5 km duke kaluar në Tilaj deri tek diga e një liqeni artificial. Rruga kalon sipër digës dhe pas 540 m rruga merr një kthesë në të djathtë. Në këtë pikë (Wp2) merr kthesën në të djathtë.Pjesa tjetër e rrugës mund të jetë me baltë pas shirave. Në këtë rast, vazhdoni të ndiqni rrugën me çakull e cila kalon mbi kodra dhe mbërrini në pikën Wp4 (itinerari i shënuar me pika në hartë).Itinerari vashdonmidis fushave nën Seferaj dhe vazhdon në drejtim të Jugut. Merrni kthesën në të majtë (Lindje) pas 750 m (Wp3) në një rrugë më të vogël. Kjo rrugë ka disa kthesa por drejtimi kryesor është Jug-Lindje.
2.5 km pas pikës Ëp3 në një përrua të vogël rruga degëzohet dhe ju do të merrni degëzimin në të djathtë. Rruga vazhdon midis fushave deri në një përrua tjetër (Wp5). Pasi kaloni përroin , rruga vazhdon majtas deri në fshatin Zikularaj, ku dhe përfundon në një rrugë më të madhe afër me një liqen artificial. Vazhdoni rrugën dhe pas afërsisht 1 ore do të mbërrini në një dyqan në Helmas. Në pranverë dhë vjeshtë, mënyra më e mirë për të arritur në pikën Wp7 është duke ndjekur itinerarin me pika të treguar në hartë. Vazhdoni ecni në Jug deri në kryqëzimin tjetër për rreth 1.1 km (pika Wp8) dhe më pas duke mbajtur drejtimin Jug-Lindje deri sa të arrini në fshatin Memzote. Me të arritur në fshat mund të pyesni banorët për një vend për të fjetur ose të vazhdoni rrugën deri në Kryeuz. Aty pranë ka një hotel ku mund të qëndroni.

Seksioni 2 Memzote – Kryeuz – Memolaj – Hasdushk – Rrezej – Karinë – Peqin

Ky itinerar kalon nëpër një rrugë të vjetër të pashtruar e cila është paralele me Via Egnatia por disa qindra metra më lartë në kodër. Ky itinerar ju ofron pamje të detit, të ultësirës dhe sigurisht të Via Egnatia. Ju do të kaloni midis një ullishteje të vjetër të bukur dhe në fund zbrisni në luginën e Lumit Shkumbin në stacionin e dytë: Peqin

| | |
|---|---|
| Distance | 22km |
| Maximum altitude | 282m |
| Total ascent/descent | 700m/700m |
| Rating | easy/moderate |
| Maps | Soviet maps K-34-100-A+C+D |
| Water | ask at farmhouses, springs at 7km and 14km |
| Accomodation | hotels in Peqin |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Wp9 | 41°09.245'N | 19°36.588'E | Wp10 | 41°08.495'N | 19°36.288'E |
| Wp11 | 41°07.793'N | 19°36.934'E | Wp12 | 41°07.285'N | 19°37.733'E |
| Wp13 | 41°06.851'N | 19°38.356'E | Wp14 | 41°06.821'N | 19°38.513'E |
| Wp15 | 41°06.291'N | 19°38.760'E | Wp16 | 41°06.091'N | 19°40.047'E |
| Wp17 | 41°06.167'N | 19°40.379'E | Wp18 | 41°05.924'N | 19°40.950'E |
| Wp19 | 41°05.862'N | 19°41.032'E | Wp20 | 41°05.814'N | 19°41.097'E |
| Wp21 | 41°05.934'N | 19°41.443'E | Wp22 | 41°05.764'N | 19°41.844'E |
| Wp23 | 41°04.705'N | 19°42.527'E | Wp24 | 41°04.322'N | 19°43.196'E |
| Wp25 | 41°03.671'N | 19°43.286'E | Wp26 | 41°03.082'N | 19°43.803'E |
| Wp27 | 41°02.744'N | 19°45.018'E | | | |

Kthehuni në të djathtë (Jug-Perëndim) në rrugën me çakull në Memzote (Wp9) dhe kaloni Lumin e Darcit pas 700m. Do të mbërrini në një kryqëzim ku do të merrni kthesën në të djathtë. Rruga ka kthesa të buta në formë L. Vazhdoni për vetëm 100 m pas kthesës së dytë dhe kthehuni në të majtë pasi shikoni shtëpiat e para në Kryeuz. Edhe në dy kryqëzimet pasardhëse mbani drejtimin majtas dhe ecni nëpër rrugën e cila kalon mbi kodër. Rruga e gjatë 12 km dhe të mundëson pamjen e lumit të Darcit në Lindje. Në Perëndim shtrihet edhe gjurma e Via Egnatia, me shumë mundësi ku kalon autostrada e ditëve të sotme. Në drejtimin Veri-Perëndim mund të shihni Durrësin.Rruga zbret nëpër kodër deri në Harizaj por itinerari ndjek një rrugë tjetër që të çon në pikën Wp10. Vazhdoni të ndiqni këtë rrugë duke mbajtur në të djathtën tuaj kodrën.Zbrisni në fshatin tjetër duke kaluar nëpër livazh dhe kthehuni në të majtë (Wp11).



©VEF




**Ura Qukës 1850**

**Qukës 2015**





